

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/MITROVICA

P. nr. 62/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/MITROVICA, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa, si Kryetare e trupit gjykues, dhe Gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe Iva Niksic si anëtare të panelit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Chiara Tagliani si procesmbajtëse, në rastin penal kundër:

I. H.,;

S. H.,;

S. S.,;

Të gjithë të akuzuar përmes aktakuzës PPS 23/13 të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me datë 13 nëntor 2013, dhe parashtruar me 13 nëntor 2013;

Të gjithë të liruar në shkallë të parë përmes Aktgjykimit nr. P. 941/2013, lëshuar me 29 maj 2014;

Të gjitha të përfshira në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR Nr. 39/2015 me 05 prill 2016;

Për të akuzuarin S. S.

Krime lufte kundër popullatës civile, parashikuar dhe dënuar me Nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e ndëshkueshme nën nenin 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sepse, në kundërshtim me **nenin 3 të Përbashkët për të katër konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe të **neneve 4 dhe 5 të protokollit II** të datës 8 qershor 1977, shtesë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë dhe në çdo kohë të rëndësishme për aktakuzën e sotme, i pandehuri në cilësinë e tij si anëtar i lartë i UÇK-së, në bashkëkryerje me anëtarët e tjerë deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, **ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetin e Dëshmitares A dhe Dëshmitares B**, dy femra civile shqiptare të Kosovës, duke i rrahur vazhdimisht ato;**

Në L. (Komuna e S.), në një datë të pacaktuar në fund të vitit 1998/fillimi i vitit 1999.

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, më 16 shtator 2016 dhe 01 nëntor 2016 në praninë e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës, të akuzuarit **I. H.** , avokatit të tij mbrojtës M. H. , të akuzuarit **S. H.** , avokatit të tij mbrojtës G. R. , dhe të akuzuarit **S. S.** me avokat mbrojtës G. G.-S. me 16 shtator 2016 dhe avokatit mbrojtës T. G. me 01 nëntor 2016;

Duke pas pranuar “tërheqjen e aktakuzës” të parashtruar nga Prokurori me datë 26 tetor 2016;

Në bazë të nenit 363, Paragrafi (1) nën-paragrafi (1.1) dhe nenit 366 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK) më 01 nëntor 2016 në një seancë të hapur dhe në praninë e të gjitha palëve;

Lëshon si në vijim:

AKTGJYKIM

I.

Akuza "**Krime lufte kundër popullatës civile**" kundër të pandehurit **I. H.**, e dhënë dhe e dënuar me Nenin **142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ)**, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe në shkelje të **nenit 3** të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe **neneve 4 dhe 5 të Protokollit II** të datës 8 qershor 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, **REFUZOHET.**

II.

Akuza '**Krime lufte kundër popullatës civile**' kundër të pandehurit **S. H.**, e dhënë dhe e dënuar me Nenin **142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ)**, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe në shkelje të **nenit 3** të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe **neneve 4 dhe 5 të Protokollit II** të datës 8 qershor 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, **REFUZOHET.**

III.

Akuza '**Krime lufte kundër popullatës civile**' kundër të pandehurit **S. S.**, e dhënë dhe e dënuar me Nenin **142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ)**, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe në shkelje të **nenit 3** të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949, dhe **neneve 4 dhe 5 të Protokollit II** të datës 8 qershor 1977, Shtesë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949, **REFUZOHET.**

IV.

Në bazë të nenit 454, Paragrafi (1) i KPP-së, shpenzimet e procedurës penale do të paguhet nga mjetet buxhetore.

Roxana Comsa
Kryetare e trupit gjykues
Gjyqtare e EULEX-it

Franciska Fiser
Anëtare e panelit
Gjyqtare e EULEX-it

Iva Niksic
Anëtare e panelit
Gjyqtare e EULEX-it

Chiara Tagliani
Procesmbajtëse

Këshillë ligjore: Në bazë të Nenit 380 të KPP-së, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës.